



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 40.2 shkronjat b) dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, nenit 30 paragrafi 2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Ligjit nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 34 paragrafët 2.2 dhe 2.3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2022, miratoi këtë,

### VENDIM PËR RIALOKIMIN E INVESTIMEVE KAPITALE TË KOMUNËS PËR VITIN 2022

#### Neni 1

1. Riallokohen mjetet nga granti qeveritar - 10, për Investime Kapitale – 30, si vijon;

**1.1. Nga programi 66030 – Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ, kodi funksional - 0620, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi - 30:**

- Ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistratja Podujeve Prishtinë deri në rrugën “Vëllezërit Frashëri” dhe rrugën “Shaban Shala” me “28 Nëntori”, kodi-51911, shuma.....705,574.00 €
- Totali.....705,574.00 €**

#### Riallokohen në:

- Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës“ Skënderbeu” me infrastrukturë përcjellëse, Kodi 49283, shuma.....532,824.00 €
  - Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve dhe rrugicave të qytetit, kodi 46396, shuma.....172,750.00 €
- Totali..... 705,574.00 €**

#### Neni 2

Riallokimi i mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi në kategorinë ekonomike Investime Kapitale, kodi-30, bëhet për arsye se në disa kode të projekteve ka tepriçë të mjeteve, ndërsa në disa kode tjera ka mungesë.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr. prot. 01-400/03-0084078/22  
Podujevë, datë, 29.09.2022



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha